



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 19
Prishtinë, më 15 nëntor 2011, në orën 14:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

P r o c e s v e r b a l

Nga takimi i Komisionit për Punë të Jashtme me delegacionin britanik në Unionin Ndërparlamentar dhe nga vazhdimi i mbledhjes së Komisionit

Delegacioni britanik në Unionin Ndërparlamentar, ishte në përbërje të deputetëve: z.Lord Bowness dhe z. Jackie Doyle-Price, nga Partia Konservative, z. Lord Dykes- Partia Liberal Demokratike, z. Earl of Sandwich, znj. Angela Smith- nga Partia e Punës, z.Lord Hylton dhe znj. Agnieszka Suchenia, asistente e sekretarisë.

Në takim morën pjesë: z.Albin Kurti, z.Hydajet Hyseni, z.Shaip Muja, z.Skënder Hyseni, z.Sabri Hamiti, znj.Donika Kadaj- Bujupi, z.Amir Ahmeti, z.Petar Miletqi.

Mungoi: z.Enis Kervan.

Pjesëmarrës të tjerë: Lumnije Murati- ZPRK, Shkumbin Beqiri-KDI, Sanije Berisha-OSBE.

Nga zyra e Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Albin Kurti - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

R e n d d i t e:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Takim me grupin britanik në Unionin Ndërparlamentar;
3. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja dhe takimi i datës, 1 nëntor 2011;
4. Shqyrtimi Raportit të Progresit dhe i Propozimplanit të Veprimit të Kuvendit për integritet evropian, për vitin 2012;
5. Të ndryshme.

1. Takim me grupin britanik në Unionin Ndërparlamentar

Albin Kurti - Në diskutimin e tij, në mes tjerash theksoi se Kosova është një shtet i ri, i dobët por që duhet të forcohet dhe të shndërrohet në një shtet normal me aspirata për anëtarësim dhe integrim në BE dhe në NATO. Integriteti territorial, sovraniteti dhe zhvillimi ekonomik, paraqesin një sfidë të madhe për Kosovën. Lidhur me integritetin territorial e sovranitetin e Kosovës, ai tha se, problem janë strukturat paralele të Serbisë, të cilat paraqesin shprehje të Kushtetutës së Serbisë, që pretendon që Kosova të jetë pjesë e saj. Qëndrimi i udhëheqjes së Beogradit, ndaj Kosovës, nuk ka ndryshuar, ajo kërkon për serbët në Kosovë, atë që nuk e ofron për shqiptarët në Luginën e Preshevës. Falënderoi parlamentarët nga Britania e Madhe për mbështetjen e vazhdueshme që i kanë dhënë Kosovës.

Lord Bowness - Tha se, kjo vizitë është realizuar me qëllim të mbështetjes së aspiratave të Kosovës për të ardhmen e saj dhe integrimin në strukturat evropiane. Ai Shprehu kënaqësinë që gjendet në Kosovë, duke shpresuar se ky takim paraqet vetëm fillimin e këmbimit të përvojave.

Earl of Sandwich- Me e rastin e prezantimit të tij, njëkohësisht shtroi edhe pyetjen se cili është qëndrimi i Lëvizjes Vetëvendosje! lidhur me dialogun me Serbinë, pasi që kishte informacione se kjo Lëvizje kishte një qëndrim më të ashpër ndaj dialogut.

Albin Kurti - Duke u ndërlidhur me pyetjen e parafolësit tha se, Lëvizja Vetëvendosje! e kundërshton dialogun me Serbinë, ngase e konsideron pa kushte të dhëna për serbet, ndërsa me kushte të dhëna për shqiptarët, se nuk është në interes të Kosovës dhe nuk është i iniciuar nga Kosova dhe se me këtë dialog, po krijohen më shumë pasoja në veri të Kosovës. Serbia e ka përfshirë Kosovën në kushtetutën e saj dhe po e pengon pavarësinë e Kosovës. Ai shtoi se Serbia duhet të kushtëzohet me njohjen e pavarësisë së Kosovës, duke kërkuar që ta ndërpresë financimin e strukturave paralele, ndihmën në kthimin e trupave të të zhdukurve, kompensimin për dëmet, kthimin e kursimeve të qytetarëve tanë, kthimin e artefakteve kulturore, të regjistrave të kadastrave dhe atyre civile. Përderisa dialogu do të duhej të normalizonte situatën në Kosovë, tha se, tani nga ai pritet të lëshohen targat e UNMIK-ut edhe për 5 vite, të kthehen regjistrat jo origjinalë dhe të njihen vetëm disa vula, pa fjalën “Republikë” .

Skender Hyseni- Sa i përket dialogut tha se, si parti nuk kemi qëndrim kritik, sepse ai është instrument i cili të sjellë deri tek pajtimi dhe respekti në mes shteteve të ndryshme, por ky dialog ka filluar me ngut, pa u përgatitur mirë dhe pa objektiva të qarta, të cilat do të duhej të arriheshin përmes këtij dialogu. Kosova para se të bisedojë me Serbinë, do të duhej të bënte koordinim me Brukselin dhe Uashingtonin, të parashihet një kornizë të parimeve, nga e cila do të udhëhiqej dhe nuk do të mund të devijonte asnjë parti.

Lord Bowness - Pyeti kryetarin e Komisionit: Cila do të ishte sipas tij, zgjidhja alternative për dialogun me Serbinë?

Albin Kurti - Ky dialog nuk përfaqëson ndonjë ide reale politike. Ne duhet t'i kthehemi vetvetes dhe Kosovën e pavarur ta bëjmë me integritet territorial, zhvillim ekonomik e sundim të ligjit. Me këtë dialog, druajmë se do të krijojmë një shtet brenda shtetit, apo ndonjë formë tjetër që parapëlqen Serbia.

Hydajet Hyseni – Në diskutimin e tij, pos të tjerash theksoi se nga partia e cila vjen, është pranuar dialogu si një rrugë normale për zgjidhjen e problemeve të pazgjidhura me gjithë dyshimin për atë se Beogradi e dëshiron vërtet një dialog produktiv e të drejtë për Kosovën. Në Kosovë nuk dëshirohet diç e privilegjuar, por insistohet në standarde evropiane për zgjidhjen e çështjeve. Beogradi nuk e ka shprehur gatishmërinë për të bërë garë pozitive në ndërtimin e standardeve evropiane karshi pakicave. Në këtë aspekt, Kosova është shumë më evropiane.

Angela Smith - Kërkoj të informohet për rolin e BE-së, në dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ajo tha se, Serbia nuk mund të hyjë në BE pa njohjen e pavarësisë së Kosovës, dhe pyeti se ky kushtëzim a ka qenë i mjaftueshëm nga BE.

Sabri Hamiti - Duke u ndërlidhur me pyetjen e deputetes, Angela Smith, u përgjigj se Evropa deri më tani, nuk i ka plotësuar kërkesat e palës kosovare në dialogun Kosovë- Serbi, aq më tepër, sepse ky dialog ishte një kushtëzim i bërë indirekt nga BE-ja, përmes një rezolute të miratuar në Asambleenë e OKB-së, e cila rezolutë, prapë ishte një kompromis që i është bërë Serbisë pas vendimit të GJND-së për pavarësinë e Kosovës. Në dialogun me Serbinë, janë të involvuar dy përfaqësues evropianë, z. Cooper dhe baronesha Ashton, por ne nuk shohim një mendim unik të Evropës rreth dialogut të Kosovës dhe Serbisë, përderisa pesë vende të BE-së nuk e njohin Kosovën dhe kanë filluar që agjendën e tyre ta bëjnë dominonte në raport me Kosovën. Evropa mund të jetë konstruktive, duke thënë se s'ka anëtarësim të Serbisë në BE, pa e njohur Kosovën. Kjo është e thjeshtë dhe e domosdoshme, nëse thuhet vetëm në kuptimin pedagogjik, që të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor do të hyjnë në Evropë, atëherë vetëm edhe një ditë nëse Serbia do të anëtarësohet në BE para Kosovës, ajo do të përpiqet të bëjë embargo për Kosovën.

Donika Kadaj-Bujupi - Falënderoi delegacionin për ndihmën e deritanishme politike dhe kërkoj nga parlamentarët britanikë, që të ndikojnë në vendet e tyre për zhvillim ekonomik dhe investime ekonomike në Kosovë.

Lord Bowness - Në Kosovë ka kornizë legislative, shpresojmë se do të ketë më tepër investitorë. Kërkesën për investime në Kosovë, tha se ne do ta përcjellim në vendin tonë.

Shaip Muja - Në diskutimin e tij, u shpreh në favor të dialogut të filluar me Serbinë, duke shtuar se ndërmjetësuesit ndërkombëtarë të këtij dialogu, BE-ja dhe SHBA-të, nuk do të lejojnë kriza të pamenaxhuara në Ballkanin Perëndimor. Kosova është duke e forcuar shtetësinë e saj në mënyrë të përhershme. Më 25 korrik, Kosova ka bërë përpjekje që ta shtrijë prezencën e vet shtetërore në veri dhe t'i shpartallojë grupet kriminale të cilat veprojnë atje. Komuniteti serb është i integruar në strukturat shtetërore, si në nivelin lokal, ashtu edhe në atë qendror. Kërkoj angazhimin e këtij delegacioni për të ndikuar në pesë vendet e BE-së që ta njohin Kosovën, sepse njohja e Kosovës edhe nga këto vende, do të ishte shumë e rëndësishme për Kosovën dhe perspektivën e regjionit.

Amir Ahmeti - Kërkoj nga delegacioni që të ndikojnë tek kolegët e tyre, të pesë vendeve të BE-së, që edhe ato vende ta njohin shtetin e pavarur të Kosovës.

Lord Bowness - Falënderoi për takimin, dhe shtoi se do të angazhohet, që kërkesat e parashtruara t'i përcjellë tek kolegët e tij. Në fund të takimit, i dhuroi kryetarit të Komisionit një dhuratë simbolike.

Pas përfundimit të takimit me delegacionin, Komisioni vazhdoi punën me pikat e parapara të rendit të ditës.

2. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi rendin e ditës.

3. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhja dhe takimi i datës 1 nëntor 2011

Kryetari konstatoi se Komisioni i miratoi procesverbalet nga mbledhja dhe takimi i datës 1 nëntor 2011.

4. Shqyrtimi Raportit të Progresit dhe i Propozimplanit të Veprimit të Kuvendit, për integritet evropiane për vitin 2012

Albin Kurti - I njoftoi anëtarët e Komisionit se Komisioni për Integritet Evropiane, mbështetur në Raportin e Progresit, e ka hartuar Propozimplanin e Veprimit të Kuvendit për integritet evropiane për vitin 2012, i cili u është shpërndarë komisioneve parlamentare për t'i shqyrtuar secili nga aspekti i veprimeve që duhet t'i ndërmarrin gjatë vitit 2012. Në pikën 3 e 4, janë paraparë veprimet e njëjta për të gjitha komisionet parlamentare, ndërsa në pikat 74 dhe 77, janë paraparë veprimet e Komisionit për Punë të Jashtme, gjatë tremujorit të dytë të vitit 2012, për të cilat mund të propozojmë ndonjë ndryshim apo plotësim të tyre.

Pas shqyrtimit të pikave të propozuara nga Plani i Veprimit të Kuvendit për integritet evropiane për vitin 2012 nga anëtarët e Komisionit, kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë

P ë r f u n d i m

Përkrahet Propozimplanin i Veprimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për integritet evropiane për vitin 2012.

5. Të ndryshme.

Anëtarët e Komisionit diskutuan lidhur me procedurën që duhet zhvilluar për kandidatët e propozuar për ambasadorë. Komisioni vendosi të ftohet ministri, Enver Hoxhaj në një takim të përbashkët lidhur me propozimin e kandidatëve për ambasadorë, ndërsa më 30 nëntor 2011, të mbahen seancat dëgjimore për kandidatët e propozuar për postet e ambasadorëve.

Takimi përfundoi në orën 16:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Albin Kurti

